



Fjala e redaksisë

Të nderuar lexues të gazetës sonë elektronike "Arsimimi sot", nëntori na kujton gjithmonë momente krenarie. Në të gjitha etapat kur vendosë për fatin e kombit mësimdhënësit nëpër shekuj e dekada ishin shembull i angazhimit e sakrificës sublimë dhe prandaj përgëzimet për festat e mëdha u takojnë me plot respekt. Andaj shfrytëzojmë rastin që edhe përmes kësaj gazete të u urojmë festën e madhe të Flamurit.


SBASHK-u me angazhimin tuaj të përkushtuar ka shtuar respektin kudo në Kosovë e botë. Po edhe në vende të tjera në Ballkan, Evropë e Kosovë. Po punojmë bashkë qetë e pa u ndalur në shërbim të arsimit në Kosovë dhe vazhdojmë të jemi zë e dëgjuar kudo i anëtarëve tonë të shumtë. Bashkë e në SBASHK mund të arrijmë të realizojmë gjithë misionin tonë. Bashkë do të realizojmë kërkesat dhe të drejtat e kolegëve tanë.

Në këtë numër të ri të gazetës sonë mund të lexoni të gjitha aktivitetet që kishim gjatë muajit nëntor.

Vazhdojnë takimet me DKA-të

Në kuadër të aktiviteteteve rreth takimeve në DKA-të komunale, delegacioni i SBASHK-ut, në përbërje nga kryetari Rrahman Jasharaj, nënkryetari Lutfi Mani, anëtarë i kryesisë Hajriz Berisha, në fillim të muajit nëntor, kanë vizituar komunën e Prizrenit. Fillimisht u takuan me kryetarin e kuvendit të SAF dhe SAM të Prizrenit, z. Reshit Kushaj si dhe me anëtarin tjetër të kryesisë së SBASHK-ut z. Besnik Krasniqi në mënyrë që të vizitojnë bashkërisht DKA-në e kësaj komunë. Drejtori i DKA-së në këtë komunë z. Nexhat Çoçaj, mirëpriti delegacionin tonë dhe pati shumë lavdata për bashkëpunimin e DKA-së që ai drejton me sindikatën e arsimit në Prizren. Gjithashtu ai është shprehur i gatshëm të bashkëpunojë edhe në të ardhmen për arsimin në këtë komunë.

Kryetari I SBASHK-ut, z. Jasharaj e përgëzoi drejtorin z. Çoçaj për punën dhe angazhimin dhe njëkohësisht e njoftoi se SBASHK-u është duke vizituar DKA-të komunale në mënyrë që të bashkëpunojë Kontratën Kolektive. Sikurse në të gjitha DKA-të tjera, edhe këtu, delegacioni i SBASHK-ut kanë kërkuar që të bëhen planifikime buxhetore për zbatimin e plotë të Kontratës Kolektive, gjë që edhe kjo DKA është pajtuar me këtë propozim dhe ka shtuar se bashkëpunimin me SBASHK-un do ta vazhdojë edhe në të ardhmen. Po të njëjten ditë, ky delegacion vizitoi edhe komunën e Dragashit, gjegjësisht DKA-në në këtë komunë. Atje u takuan me kryetarin e SAF dhe SAM z. Ajet Reshiti dhe se bashku vizituan drejtorin e DKA-së së kësaj komunë, z. Hajri Ramadani




Projecti i financuar nga BE dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë. Logos for KEC and other partners.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Marrëveshje në shërbim të anëtarësisë edhe në Komunën e Drenasit, Pejës e Prizrenit

Drejtori z. Ramadani ka përgëzuar SBASHK-un për angazhimin e saj për anëtarësinë e vet si dhe ka treguar se bashkëpunimi i ndërsjellë në mes të DKA-së në këtë komunë si dhe sindikatës së arsimit nuk mungon dhe do të vazhdojë edhe në të ardhmen, në të mirë të arsimit. Edhe në këtë komunë delegacioni i SBASHK-ut ka treguar qëllimin e vizitës dhe po ashtu edhe drejtorin i DKA-së në Dragash është pajtuar me propozimin për planifikim buxhetor për implementimin e plotë të Kontratës Kolektive. Gjithashtu ai na njoftoi se edhe në komunën e Dragashit vërehet një rënie e numrit të nxënësve. Dhe në fund të takimeve me DKA-të, delegacionin e SBASHK-ut e mirëpriti edhe Kryesia e Sindikatës së arsimit të Prizrenit, ku zhvilluam një takim pune.

Angazhimi i përbashkët i SBASHK-ut në qendër dhe në nivelet komunale ka bërë që të shtohen sukseset. Një pjesë e aktivitetit i është kushtuar takimeve me bizneset dhe nënshkrimi i marrëveshjeve për zbritje çmimesh të shërbimeve për anëtarët e SBASHK-ut kudo në Kosovë. Edhe Komuna e Drenasit ka nisur t'i bashkëngjitet suksesëshëm këtij aktiviteti. Kryetari i Kuvendit të SAF e SAM në këtë Komunë z. Hajriz Berisha ka nënshkruar marrëveshjet e para me Ndërmarrjen Tregtare "Jora Center" për zbritje çmimesh prej 3% për artikuqit ushqimor dhe 7% për tekstil e teknikën e bardhë. Një marrëveshje tjetër për zbritje çmimesh për shërbimet është nënshkruar edhe me Dr. Ilir Topilla "Dardani Dent". Anëtarët e SBASHK-ut nga komuna e Drenasit në këtë Ordiancë do të gëzojnë zbritje çmimesh për shërbimet dentare prej 15%.



Gjatë këtij muaji u hetua një frymë e vazhdueshme e punës dhe e angazhimeve në shërbim të anëtarëve të SBASHK-ut kudo në Komunitet e Kosovës. Kryetarët e niveleve komunale kanë shtuar angazhimet edhe në arrijtjen e marrëveshjeve të reja me bizneset për zbritje çmimesh të shërbimeve të mësimdhënësit sindikalistë. Kohëve të fundit marrëveshje të tilla janë nënshkruar edhe në Prizren e Pejë. Në Prizren veprimtarët sindikalë Reshit Kushaj e Besnik Krasniqi të ndihmuar edhe nga anëtarët e Kryesisë së SAF e SAM të kësaj komunë kanë nënshkruar marrëveshje me barnatoren "Barkos", të pronarit Gyner Gashi. Shërbimet këtu janë për 10% më lirë. Po ashtu është arritur marrëveshja edhe me Ordiancën Stomatologjike "Kuki-Dent", të pronarëve Bislim dhe Miran Sadiku. Edhe këtu shërbimet janë me zbritje për 10% për anëtarët e SBASHK-ut në Prizren. Në këtë ordinancë mund të kryhen edhe shërbimet në stomatologji, neuropsikiatri, pediatri dhe shërbime laboratorike. Edhe në Pejë janë arritur marrëveshjet e para. Qendra tregtare "Magic" në Arbnesh (ish Vitomiricë), me pronarin Esat Delijaj, për anëtarët e SBASHK-ut nga e tërë Kosova ofron artikuq të shumtë me zbritje prej 10%. Po ashtu kryetari Isuf Lajci i përkrahur nga veprimtarët të tjerë sindikalë kanë arritur marrëveshje edhe me Ndërmarrjen e njohur "Kastrati". Në autolarje zbritja e shërbimeve është 20%, në ndërrim gomash 30% zbritje në bashkëpunim me "Euro-Goma". Sindikalistët këtu edhe mund të kalojnë kohë relaksuese sepse mund të luajnë "Boëling" me zbritje prej 20%. Mund të ushqehen pastaj në piceri me zbritje prej 10% dhe në fund të marrin edhe derivate për makinën me zbritje prej 1 cent për litër. SBASHK-u falënderon për mirëkuptimin e punës dhe të angazhimit të "Kastrati", z. Fatos Elezaj.




Projecti i financuar nga BE dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë. Logos for KEC and other partners.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Takime me kolegët sindikalistë në gjithë Kosovën

Pasi kanë kryer vizitat e punës në shumicën e DKA-ve, delegacionet e SBASHK-ut, të kryesuar nga kryetari Rrahman Jasharaj, kanë realizuar takime me anëtarët e Kuvendëve të SAF e SAM nëpër komunat e Kosovës. Është nisur me Prishtinën e Malishevën për të vazhduar me Pejë, Klinë, Ferizaj, Mitrovicë, Prizrenin, Gjakovën. Delegacioni i SBASHK-ut është pritur mirë kudo mes kolegëve sindikalistë. Ata kanë folur për angazhimet konkrete dhe kanë dhënë përgjigje në të gjitha pyetjet e shprehura. Në të gjitha këto takime është thënë se një frymë e mirë e punës, transparencës dhe e angazhimit në shërbim të anëtarësisë dhe arsimit në tërësi po vërehet gjithnjë e më shumë. Në Mitrovicë, Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Malishevë, Klinë, Ferizaj, Pejë është përkrahur e lavdëruar angazhimi i kryetarit i Kryesisë dhe Këshillit Drejtues. Pjesëmarrësit në takime kanë kërkuar që SBASHK-u të jetë kategorik edhe në të ardhmen në mbrojtjen e të drejtave të anëtarësisë dhe në vënien në jetë të tërë Kontratës Kolektive. Në këto takime është përkrahur ideja e kryetarit që pas ciklit të takimeve me anëtarët e Kuvendëve të SAF e SAM në të gjitha komunat e Kosovës të nis një cikël i ri i vizitave nëpër shkollat e ndryshme kudo në Kosovë. Delegacioni i SBASHK-ut kudo është shprehur se me kënaqësi do t'i përgjigjet ftesave për takime nga cila do shokollë në Kosovë dhe se SBASHK-u do të vazhdojë me angazhimin e shumta në shërbim të anëtarësisë. Kudo në këto Kuvende është kritikuar ashpër përpjekja e dështuar e një grupi për gjoja sindikata të reja. "Ne kemi sindikatën tonë me emrin SBASHK. Po angazhohemi bashkërisht dhe do ia arrijmë të realizojmë gradualisht kërkesat dhe misionin tonë. Përpjekjet për përçarje kanë dështuar e do të dështojnë gjithmonë", ishte konkluzioni i të gjithë pjesëmarrësve në këto takime. Në këto takime i është kërkuar të kryetarin edhe nënkryetarët Lutfi Mani e Rexhep Sadiku dhe menaxheri financiar Ymer Ymeri duke dhënë kontribut të çmuar në informimin e drejtë e të saktë të pjesëmarrësve në këto Kuvende. Në të gjitha këto Kuvende është kërkuar që të vazhdohet me unitet dhe është thënë se do të jemi gjithmonë bashkë e në SBASHK



Takim i përbashkët i MASHT-it, SBASHK-ut dhe DKA-ve lidhur me Kontratën Kolektive


SBASHK-u insiston që në janar Kontrata të implementohet në tërësi Në frymën e mirëkuptimit e angazhimit të përbashkët për të gjetur mundësi me qëllim të implementimit të plotë të Kontratës Kolektive për sektorin e arsimit, pas takimeve të shumta nëpër komuna dhe shuma nëpër komunat e MASHT-it më datë 12 nëntor është mbajtur një takim i përbashkët i përfaqësuesve të MASHT-it, SBASHK-ut edhe drejtorëve të Drejtorive Arsimore dhe të vetmet dështje të diskutimit ishin implementimi i Kontratës Kolektive, të nënshkruar në prillin e këtij viti nga MASHT-i dhe SBASHK-u dhe përpilimi i një forme unike të kontratës individuale për gjithë Arsimin Parauniversitar të Kosovës.



Projecti i financuar nga BE dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë. Logos for KEC and other partners.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe menaxheri financiar Ymer Ymeri kanë përsëritur se ata edhe në këtë takim janë zëri i mijëra mësimdhënëseve sindikalistë dhe se ata duke bartur këtu zërin e tyre inishtojnë që Kontrata Kolektive të zbatohet që tani në pikat që nuk kërkojnë implemtim buxhetore, kurse në janar të gjenden mundësi e mjete për implementimin e plotë të saj duke përfshirë edhe shuajtjen, kompensimin për udhëtimin e mësimdhënëseve, shpërblyerjen prej 0.5% për vitet e shërbimit dhe tri pagat shpërblyese për mësimdhënësit që pensionohen.



Po ashtu ishte deklaruar e përbashkët se SBASHK-u dhe DKA-të nuk konsiderohen si kundërshtarë, po si palë të negociimit e angazhimit të përbashkët në shërbim të arsimit në Kosovë. Lidhur me Kontrata individuale është formuar një komision, në përbërjen e të cilit është edhe SBASHK-u, i cili do ta përpilojë një kontratë unike individuale për gjithë Arsimin Parauniversitar dhe se deri atëherë nuk do të lëshohet as edhe një lloj Kontrate tjetër individuale nga DKA-të.

SBASHK-u harton projekt strategjinë 2015-2019


Në SBASHK thonë se ngritja e një strategjie është fort e rëndësishme pikërisht në kohën kur shtrohen shumë sfida e pikëpyetje. Strategjia do të jetë bazë e veprimit unitet dhe mbështetje për angazhimin e veprimit të koordinuar mes qendrës dhe niveleve të arsimit dhe anëtarësisë në mbrojtje të të drejtave sindikale dhe në qëndrimin kategorik se Kontrata Kolektive do të realizohet e tëra në janar. Nëse kjo nuk ndodh atëherë Strategjia përcakton edhe masat dhe veprimet konkrete e unike në mbrojtje të saj.



Projecti i financuar nga BE dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë. Logos for KEC and other partners.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Në kuadër të aktiviteteteve të shumta nga Projekti i përbashkët mes KEC-it (Qendra për Arsim e Kosovës) dhe SBASHK-ut, me titull "Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave arsimore", mbështetur nga Komisioni i Evropës, nga 14 deri më 17 nëntor ka mbajtur një Punëtori të rëndësishme, udhëhequr nga prof.dr. Dukagjin Pupovci, ku është hartuar korniza e planit strategjik të SBASHK-ut. Në këtë punëtori ishin prezent përfaqësues të SBASHK-ut nga shumica e komunave të Kosovës, si dhe një përfaqësues i DKA-ve z. Musaj Tërbanja dhe një nga MASHT-i z. Arian Mustafa, të cilët kanë dhënë kontribut të çmuar gjatë gjithë seanceve të punëtorisë.




Në hapje të kësaj punëtorie, kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, ka numëruar shumë nga arritjet e SBASHK-ut, por nuk ka harruar të përmend edhe sfidat. Ai ka lavdëruar bashkëpunimin e sinqertë të KEC-it me SBASHK-un në funksion të forcimit të vazhdueshëm të kësaj sindikate në përbalje me sfidat e kohës. Jasharaj ka lavdëruar edhe përkushtimin e z. Dukagjin Pupovci në tërë projektin dhe ka falënderuar atë për t'iu nxistur para një bashkësisë të frytshme. Pjesëmarrësit kanë deklaruar se SBASHK-u ka shënuar arritje të shumta dhe ka një historik të pasur të përkushtimit nëpër vite e dekada. Ata kanë lavdëruar edhe përpjekje të vazhdueshme të anëtarëve të sjellë liri e angazhimin pozitiv në shërbim të anëtarësisë. Mirëpo ata nuk janë ndalur me kaq, por kanë dhënë ide të shumta me qëllim që SBASHK-u të shtojë angazhimet në shërbim të anëtarësisë duke sjellë freski e risi në këtë sferë. Gjatë gjitha seanceve kishte kontribut të madh nga ana e përfaqësuesve, ku edhe me ndihmën e ideve të tyre u hartua korniza e planit strategjik të SBASHK-ut për katër vitet e ardhshme 2015-2019.



SBASHK-u në Kongresin e 9 të Sindikatës Sillovene të Arsimit (SVIZ)


Me datë 20 dhe 21 nëntor delegacioni I SBASHK-ut ishte pjesëmarrës në punimet e Kongresit 9 të Sindikatës së Arsimit, Kulturës dhe Shkencës së Sillovenisë (SVIZ). Kongresi është mbajtur në ambientet e Hotel "Gold" në qytetin e bukur të Bledit. Në këtë Kongres krahas, delegatëve nga të gjithë pjesët e Sillovenisë, ishin të pranishëm edhe Sindikatat mike të SVIZ-it nga Ballkani dhe Evropa.



Projecti i financuar nga BE dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë. Logos for KEC and other partners.


Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Mësimdhënësit e festojnë Kongresin e tyre e kishin filluar në një atmosferë të sillovene duke prezantuar Sindikatën mysafirë. Prezantimi i SBASHK-ut dhe veprimtarisë së sukseshme të kësaj Sindikate nga Kosova është përcjellë me vëmendje nga gjithë të pranishmit. Delegacioni i SBASHK-ut është përshëndetur me duartrokitje të gjata në momentin kur drejtues i punimeve të Kongresit ka përmendur emrat e tyre. Kjo dëshmon edhe një herë respektin e ndërsjellë dhe miqësinë nëpër vite e dekada, jo vetëm mes dy sindikatave, por edhe mes popullit silloven e atij shqiptar. Delegacioni i SBASHK-ut dhe menaxheri financiar Ymer Ymeri janë falënderuar mikpritësit dhe me përfaqësues të SVIZ është zhvilluar një bashkëbisedë për të gjetur mundësi të reja e për të shtuar bashkëpunimin. Delegacioni i SBASHK-ut ka zhvilluar me kënaqësi dhe me delegacionin e Sindikatave mysafirë të Kongresit. Nga këto takime ka dalë vlerësimi i përbashkët se duhet shtuar bashkëpunimi dhe se sindikatat duhet mbështetur njëra-tjetrën në përpjekjet për forcimin dhe avansimin e rolit të sindikatave në krijimin e politikave arsimore dhe për krijimin e një strategjie të qëndrueshme në mbrojtjen e të drejtave të mësimdhënëseve sindikalistë. Delegatët e Kongresit të Nëntë të SVIZ kanë zgjedhur një pjesë të organeve udhëheqëse dhe do të jenë platformë konkrete për t'u përballur me lehtë me sfidat, që si u tha nga folësit në këtë takim të madh, nuk do të jenë as të lehta e as të pakta për nga numri.



Rritet numri i marrëveshjeve në shërbim të anëtarësisë

Kryetari i Kuvendit të SAF e SAM në Komunën e Vushtrrisë e ka nisur me të mbarë këtë detyrë. Është bashkë me anëtarët e kryesisë nënshkruar marrëveshjet e para me institucione private të shëndetësisë për zbritje çmimesh për anëtarët e shumtë të SBASHK-ut në këtë Komunë. Këta mësimdhënësit falë këtyre marrëveshjeve do të kenë zbritje çmimesh prej 8% në "Blerita Pharm" të Mr. Ph. Rexhep Halimi. Një marrëveshje tjetër me rëndësi është ajo me OPS "Auris" e specialistit për hundë, fytyrë e vesh, Dr. Ibrahim Maxhuni. Z. Maxhuni ka dhënë zbritje prej 20% për shërbimet që kryhen në këtë institucion të njohur privat shëndetësor. Marrëveshja e tretë e momentit në Vushtrri është lidhur me Barnatoren "Timi Pharm" e Mr. Ph. Fahri Zabërgja. Marrëveshja përcakton zbritjen e çmimeve prej 8% për anëtarët e SBASHK-ut në këtë Komunë. SBASHK-u përgëzoi kolegun Maloku dhe kryesisë e SAF e SAM të Vushtrrisë për angazhimet dhe falënderon me shumë respekt pronarët e këtyre institucioneve privatë shëndetësore për respektin dhe mirëkuptimin e treguar për mësimdhënësit sindikalistë të Vushtrrisë.



Projecti i financuar nga BE dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë. Logos for KEC and other partners.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Këshilli Drejtues ka vlerësuar se gëzon unitetin në SBASHK dhe se kjo atmosferë e punës dhe angazhimit të përbashkët është përgjigje e fuqishme ndaj përpjekjeve mjerane të një grupi individesh për ta goditur unitetin e SBASHK-ut. Këshilli Drejtues ka bërë edhe vlerësimin në shërbim të anëtarësisë duke lavdëruar arritjet në nënshkrimin e marrëveshjeve me biznese për zbritje çmimesh të shërbimeve dhe artikuqve në shërbim të anëtarëve të SBASHK-ut. Ata kanë kujtuar se ishte caktuar si detyrë të nënshkruheshin 10 marrëveshje me institucione private shëndetësore e me biznese, por deri tani janë nënshkruar 50 sosh. Kjo arritje është fryt i angazhimit të përbashkët të SBASHK-ut në qendër dhe në nivelet komunale. Në këtë takim është prezantuar nga menaxheri financiar i SBASHK-ut, z. Ymer Ymeri, Projektbuxheti i SBASHK-ut i vitit 2015. Pas debatit konstruktiv dhe përmbajtësor Këshilli Drejtues ka aprovuar buxhetin për vitin e ardhshëm.



Projecti i financuar nga BE dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë. Logos for KEC and other partners.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Rexhepi tregon se në "Plus Market" edhe ashtu çmimet janë më të ulëta dhe këtu marrëveshja është për zbritje prej 2% për të gjithë artikuqit. Në "Fin Performance" mësimdhënësit sindikalistë do të kenë zbritje çmimesh prej 15%. Në "Melodia px" e pronarit Astrit Gashi, marrëveshja precizon se zbritja e çmimeve do të jetë 10% për zëna. Një marrëveshje me rëndësi për anëtarët e SBASHK-ut në Ferizaj është ajo me Poliklinikën dhe barnatoren "Zeka". Menaxheri këtu Mr. Ph. Z. Kamberi. Shërbimet këtu do të jenë me zbritje prej 10%. Poliklinika & Barnatorja "Zeka" përveç barnatoreve janë edhe shërbimet në laborator, rëntgen dhe kontrolli mjekësor. Edhe një marrëveshje në shërbim të anëtarësisë në Prishtinë



Projecti i financuar nga BE dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë. Logos for KEC and other partners.